



MALTIN KORKUTI

Drejtor i Përgjithshëm
CREDINS BANK

1 Në vitin e fundit ekonomia shqiptare u godit thellësisht nga dy fatkeqësi të njëpasnjëshme, si: tërmeti dhe pandemia. Mbyllja totale për disa muaj dhe hapja graduale, shoqëruar me masat për distancim social dhe kufizim të lëvizjeve, pritet të krijojë një tkurrje prej 7% të ekonomisë. Megjithatë i prekur, sektori bankar është i mirë-kapitalizuar, ruajti nivele të kënaqshme likuiditeti me norma të ulëta interesi, shoqëruar me rritje të depozitave dhe rritje të lehtë të huave.

Si përgjigje ndaj pandemisë, Banka Credins ndërmori menjëherë një seri veprimesh, për të siguruar vazhdimësinë me cilësi të veprimtarisë bankare, si:

- Aplikimi i masave për parandalimin e përhapjes së Covid-19 për stafin dhe klientët;
- Krijimi i infrastrukturës së nevojshme, për të siguruar punën nga shtëpia;
- Zbatimi i ndryshimeve të rregulloreve të Bankës së Shqipërisë, duke krijuar fleksibilitetin e nevojshëm për klientët, për shtyrje të kësteve të huave;
- Mbështetja e bizneseve

që operonin në sektorin e shëndetësisë;

- Aplikimi i kostove lehtësuese për përdorimin e kanaleve digjitale;
- Procedimi në kohë rekord për kalimin e pagave të luftës.

Sa më sipër, banka ndërmori shpenzime të paparashikuara, si përgjigje ndaj situatës, e kjo ndikoi negativisht në rezultatin e parashikuar financiar të bankës. Pas hapjes graduale, banka ndërmori disa nisma për mbështetjen e klientëve, si:

- Lançimi i huas: "SëBashku", për të mbështetur nevojat e çdo biznesi të vogël e të mesëm, për të rifilluar veprimtarinë me optimizëm;
- Lançimi i "paketës së biznesit", si një "one stop shop" për çdo biznes, për të trajtuar çdo nevojë për shërbimet bankare;
- Mbështetje e nevojave të qeverise në ankandet e letrave me vlerë, për të siguruar fondet e nevojshme për përbalimin e pandemisë.

Veprimet e ndërmarra krijuan një ecuri në rritje, veçanërisht në sektorin e pagesave, si në përdorimin e kartave, shërbimin e-commerce, transaksionet në kanalet digjitale, si dhe aplikimet online, etj. Banka Credins ruajti pozicionin e parë në treg, në totalin e portofolit të huas, me një rritje vjetore prej 4%. Vlen të nënvizohet se mbajtja nën kontroll e portofolit të huave, i cili duhet monitoruar me kujdes në muajt në vijim, mbetet një sfidë që kërkon monitorim të kujdesshëm, në varësi të zhvillimeve të mëtejshme të pandemisë.

2 Situata e pandemisë solli një përkeqësim të situatës ekonomike për shumë biznese dhe individë, duke sjellë kosto shtesë për bankën. Përtej masave të ndërmarra në kohë rekord, sfidë mbetet rimëkëmbja

ekonomike, kthimi në normalitet i shumë sektorëve të ekonomisë, kthimi i besimit të individët për të rritur konsumin dhe investimet, etj. Sot jemi më të mirë-organizuar, në kuadër të infrastrukturës bankare, për të përballuar pandeminë, por gjithsesi, normaliteti i ri mund të kërkojë masa shtesë, të cilat do vlerësohen më tej.

3 Pandemia ishte një shtysë e mirë, duke përshpejtuar disa procese të cilat në kohë normale do kishin qenë të vështira për t'u ndërmarrë. Pandemia çoi në rritje të ndjeshme të shërbimeve bankare në kanalet digjitale, të cilët do kërkonin disa vite kohë për t'u përthithur nga klientët. Kaluam emergjencën e jashtëzakonshme dhe kemi fituar eksperiencë për t'ia dalë mbanë; po respektojmë masat për punë sa më të kujdesshme për stafin dhe klientët, kemi balancuar punën nga shtëpia me atë në zyrë dhe kemi rritur vëmendjen drejt edukimit të klientëve drejt kanaleve digjitale. Vizioni ynë është për të ofruar çdo shërbim online dhe për t'i mundësuar klientit një shërbim të specializuar në degët tona, për produkte komplekse ose për klientë që kanë qasje të kufizuar në kanalet digjitale. Credins Bank ka përruruar degën Smart, një urë lidhëse midis bankingut tradicional dhe atij digjital. Objektivi është të trajnojmë, edukojmë dhe këshillojmë klientët për përdorim të aplikacioneve, si dhe rritje të përdorimit të shërbimeve bankare në mënyrë të pavarur, përkundrejt dhe aplikimeve online për çdo shërbim, nëpërmjet automatizimit të mëtejshëm të proceseve tona të brendshme. Banka Credins është vërtet një nga bankat më të mëdha në tregun bankar, por në një madhësi të pranueshme për të ndërmarrë nisma dhe për t'ju përshtatur rrugëtimit digjital të konsumatorëve.